

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës III Sesioni III

"Adoptimi dhe zbatimi i kërkesave të Bashkimit Europian për produktet BIO, produktet konvencionale dhe produktet e integruara".

2 nëntor 2015

Zhvillimet aktuale

Sipas nenit 95 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare. Grupi i Punës së Bujqësisë theksoi se duke marrë në konsideratë që 60 % e legjislacionit të BE-së përqendrohet tek rregullimi i sektorit të bujqësisë dhe ushqimit, peshën prej 24 % të PBB-së në vend të këtij sektori, si dhe potencialin e konsiderueshmë ekonomik dhe ndikimin social në Shqipëri të tij, ky sektor duhet të ketë një vëmendje të veçantë, e konkretizuar kjo me reforma të integruara të cilat nuk mund të trajtojnë vetëm problematika rastësore por duhet të adresojnë zgjidhje të qëndrueshme duke garantuar konkurrueshmërinë e këtij sektori në një treg me ndikim të ndjeshëm rajonal dhe global.

Në kuadër të Planit të Veprimit të Bujqësisë Organike, e pasqyruar dhe në Strategjinë Ndër - Sektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i kushton vëmendje zhvillimit të bujqësisë organike, duke e cilësuar atë si një prioritet, por në të mungojnë elemente që do ndihmonin zhvillimin e saj të tilla si: a) një politike kombëtare për bujqësinë organike ; b) një kuadër ligjor i plotë që do të rregullonte prodhimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve organike; c) masa konkrete mbështetjeje për prodhuesit organik si dhe masa që do të synonin rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe inkurajimin e zhvillimit të tregut; d) masa për mbështetjen e kërkimit shkencor, arsimit dhe shërbimit këshillimor për produktet BIO.

Ligji shqiptar Nr. 9199, datë 26/02/2004 "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio", synon nxitjen e prodhimit organik në Shqipëri, krijimin e kuadrit ligjor të nevojshëm dhe përcaktimin e kushteve të prodhimit, përpunimit, transportit, certifikimit dhe kontrollit të produkteve bujqësore dhe atyre ushqimore me prejardhje bimore ose shtazore, që prodhohen, përpunohen ose/dhe importohen e tregtohen si produkte "Bio". Në vendin tonë rreth 350 mijë familje që prodhojnë produkte BIO përballen me vështirësi si: çmimet e larta të plehrave

kimike, insekticidet dhe pesticidet jo- efektive, mungesë infrastrukture për ujtiqe, vështirësi dhe kosto në proceset e ambalazhimit dhe çertifikimit, si dhe mungesa e tregjeve.

Si elemente pozitive të bujqësisë organike në Shqipëri, Grupi i Punës iu referua krahuq të lirë të punës dhe tokës së pakontaminuar. Gjithashtu, kërkesa e lartë në tregjet europiane, të cilat nuk plotësohen dot për shkak të kostove të certifikimit apo krijimit të kushteve që do të mundësonin prodhimin organik të pa-ndikuar nga prodhimi konvencional, është njëkohësisht një avantazh për prodhimet shqiptare të cilat kanë një potencial të lartë për eksport, por edhe disavantazhin që me siperfaqet e vogla të kultivimit organik, ende nuk janë të konsiderueshme për tu thithur nga tregjet në të cilat ato marrin edhe një vlerë më të lartë.

Problematika & Rekomandime

Politika nxitëse, bashkëpunuese e reformuese

Sipas Grupit të Punës, bujqësia shqiptare e ka të pamundur të **konkurrojë tregun europian dhe atë fqinj** me anë të prodhimit të produkteve konvencionale, pasi niveli i prodhimit bujqësor kombëtar është 10 herë më i vogël në krahasim me vendet fqinje. Zgjidhja qëndron në ndryshimin e qëndrimit ndaj prodhimeve BIO, me anë të **një perspektive të re që nxit prodhimin** bujqësor organik, gjë që do të çonte në ulje të çmimit. Kosto do të ulej për shkak të mospërdorimit të pesticideve dhe elementeve të tjera kimike. Kështu në fund do të përfitohet prodhim me **çmim të ulët dhe cilësi më të mirë**.

Problematikë tjetër është **mbështetja e ulët ekonomike** e cila shtrohet si detyrë e qeverisë për të ngritur struktura për të bërë të mundur menaxhimin e programit dhe hartimit të politikave dhe krijimin e masave specifike, duke qenë se në dokument ka vetëm një masë të përgjithshme. Sot bujqësia merr një përqindje shumë të vogël nga buxheti shtetëror dhe gjithashtu duhet të ofrohen subvencione. Duke marrë për bazë fondet specifike që BE ofron për sektorin, Grupi i Punës renditi disa prej tyre që mund të jenë të aplikueshme dhe nga qeveria shqiptare:

1. Financim i drejtpërdrejtë për fermerët që prodhojnë BIO
Ky financim për fermerët kërkon mospërdorimin e pesticideve nga ana e tyre dhe ku duhet së paku të prodhojnë 1 deri në 2 varitete për 5% të tokës së tyre.
2. Mbështetje me teknologji të reja për peshkimin dhe akuakulturën
Vazhdimisht vihen në zbatim teknologji të reja për mbështetjen e peshkimit dhe akuakulturës dhe prodhimin uroje BIO. Asnjë nga të dy masat nuk gjen mbështetje në vendin tonë.
3. Subvencione për Kërkim dhe Inovacion në fushën e prodhimeve organike

Në Shqipëri sot ka mangësi edhe pse mundësitë për zhvillim në këtë drejtim janë të mëdha pasi ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore për kërkime lidhur me prodhimet organike dhe mund gjithashtu të kontribuohet në inovacion.

4. Skemat e fermave organike

Të tilla skema mund të realizojnë një promovim të saktë të prodhimit të produkteve organike, të tregjeve ku këto produkte mund të tregtohen etj. Vetë BE financon ato organizata që rrisin informimin për këtë sektor.

5. Skemat për ngritjen dhe mbështetjen e shoqatave të prodhuesve organikë

Duke pasur në vëmendje faktin që bujqësia është një sektor me risk të lartë (problemet e paparashikuara të motit etj.) Bashkimi Europian mbështet vazhdimisht shoqatat që kanë si qëllim të tyre sektorin e bujqësisë për të ulur rrezikun e falimentimit të tyre si dhe për të rritur sasinë e prodhimit të produkteve BIO. E njëjta gjë duhet të funksionojë edhe në Shqipëri.

6. Konsulenca, asistencë teknike për prodhuesit

BE financon dhe mbështet edhe prodhimin e integruar organik, nëpërmjet asistencave teknike falas për prodhuesit. Kjo bën të mundur shmangien e humbjeve me anë të njohjes se teknikave dhe ligjeve nga ana e prodhuesve.

E nevojshme t'i kushtohet më tepër rëndësi bletëve si indikator natyror mjaft i rëndësishëm dhe shpesh bazë në produkte të ndryshme BIO. **Mbarështruesit e bletëve** kanë gjithnjë e më pak të ardhura e mbështetje financiare në Shqipëri.

Nevoja për **rritjen e informacionit dhe ndërgjegjësimin** për fermerët në lidhje me legjislacionin shqiptar dhe atë europian, përgatitjen dhe disiplinën teknike, kërkon një **bashkëpunim dinamik mes OJF-ve, institucioneve private dhe drejtorive** teknike në institucione shtetërore. Për të pasur një bashkëpunim më të mirë mes Ministrisë së Bujqësisë me Këshillin e Agro-Biznesit Shqiptar (KASH) dhe organeve të tjera u parashtrua si zgjidhje ngritjen e një platforme elektronike të dhënash ku të renditen kriteret e kërkuara nga Bashkimi Europian dhe praktika më të mira nga rajoni.

Zbatimi i Legjislacionit

Në 2007, Bashkimi Europian ka miratuar Direktivën mbi prodhimet organike. Konsiderohet e nevojshme edhe politika e certifikimit: ekzistojnë subjekte private të shpërndara që kanë të drejtë certifikimi për produktet BIO por mungon informacioni nga ana e prodhuesve bujqësorë dhe shumë herë kostoja është mjaft e lartë për certifikimin dhe nuk kanë asnjë mbështetje nga shteti. Është i nevojshëm **certifikimi i prodhimit organik** dhe certifikimi mbetet një sfidë për prodhuesit shqiptarë. Gjithashtu mbrojtja e etiketës së prodhimeve në tregun vendas mbetet gjithashtu një sfidë: ekziston ende sistemi ku produkti organik nuk ka certifikatë dhe si pasojë kjo sjell

konfuzion. Problemi më i madh i aspektit ligjor nuk është mungesa e kuadrit rregullues por mungesa e zbatimit në praktikë të ligjit.

Siç pasqyrohet dhe në dokumentin strategjik në një seksion të veçantë të prodhimit organik, ka një mangësi të dukshme të **statistikave**. Në dokumentin strategjik pasqyrohet në një seksion të veçantë prodhimi organik por ka një mangësi të dukshme: statistikave. Statistikat e fundit të pasqyruara në dokument janë të vitit 2012 dhe nuk japin një pamje të qartë të gjendjes aktuale dhe potencialit të saj duke vështirësuar hartimin e politikave. Duhet të kemi një ligj të përditësuar sa i takon produkteve organike pasi ende operohet me ligjin e vitit 2004 dhe mungojnë edhe statistikave për këtë fushë.

Kapacitete institucionale e infrastrukture

Në aspektin institucional është Ministria e Bujqësisë me drejtoritë përkatëse që mbulon procesin e bujqësisë dhe integritit evropian. Grupi i Punës identifikoi si problematike **mungesën e specialistëve** në këtë fushë dhe mangësi në zbatimin e rregulloreve dhe politikave. Detyrat kryesore janë mbikëqyrja e tregut, mbrojtja e prodhimeve BIO, qartësimi i konsumatorit dhe rritja e kapaciteteve për hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre. Përveç nivelit teknik e profesional, **ka një mungesë të theksuar stafi**. Për shembull, në sektorin e mbrojtjes së bimëve në Ministrinë e Bujqësisë ka vetëm një person staf, për të cilin është e pamundur të mbulojë të gjitha çështjet. Ka nevojë për rritje kapacitetesh në staf.

Referuar forcimit të **kapacitetit infrastrukturor**, Grupi i Punës sugjeroi mbwshtetjen nw ngritjen e fabrikave për përpunimin e plehut organik, modernizimin e teknikave dhe mjeteve të prodhimit, zhvillimin e institucioneve kërkimore për prodhimin e farërave rezistente dhe infrastukturës ujëtare dhe të kullimit.

Në Shqipëri **nuk ekziston një treg organik**, duke rezultuar në mungesë informacioni për konsumatorët lidhur me të mirat e produkteve bio.

Në sektorin e **bimëve medicinale**, Shqipëria ka potencial prodhues por karakterizohet nga mungesë organizimi e orientimi për prodhuesit e bimëve medicinale.

Pjesëmarrës në Sesionin I, Grupin e Punës: Institucione shtetërore dhe shoqëri civile

Institucione shtetërore:

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave- Sali Metani

Agjencia Kombëtare e Ushqimit: Amnneris Drenofci, Nerta Çeço, Pamela Radovani

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Informacionit (AKTI)- Geron Kamberi

Shoqëri civile:

Këshilli i Agrobisnezit Shqiptar: Agim Rrapaj, Ymer Tola, Enida Shena, Agron Rromilli, Rexhep Shima, Hajdar Kuçi, Roza Martini

ATSH - Etleva Xhajanka

EMA - Roland Muka

Unioni Kursim Kredi - Kliton Vaso, Mariglen Shahu

AGRO Lider Invest Albania Admin- Artan Toska

Shoqata e Bletërritsave të Shqipërisë- Lejla Shehu

SHBB Elbasan - Abdyl Tabaku

Shoqata Kombëtare e Blegtorëve Shqiptarë

LEAA-Kujtim Xokoli

BIOADRIA association- Florian Paspali

Butrinti Fermë- Albert Pashaj

KEPUTA sh.p.k- Eduart Këputa

Dhoma Kombëtare Avokatisë - Kadrije Gurmani

EKR- Endrit Rrapaj

LIT MONOFILATI LTD- Edmond Qenani

Kantina Isak- Joana Sinani

Media



KASH Agroweb- Elvira Çeku

RTSH-Bjolanda Cuku